



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS PËR VITIN 2021

Prishtinë, qershor 2022

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

- 1 Opinioni i Auditimit
- 2 Gjetjet dhe rekomandimet
- 3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit
- 4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

1 Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e pasqyrave financiare të Këshillit Prokurorial të Kosovës për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2021, në përputhje me Ligjin për Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Auditimi është kryer për të na mundësuar të shprehim opinionin për pasqyrat financiare dhe konkluzionin për pajtueshmërinë me autoritetet.¹

Opinion i pamodifikuar për pasqyrat financiare vjetore

Ne i kemi audituar pasqyrat financiare vjetore të Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), të cilat përmbajnë pasqyrën e pranimeve dhe pagesave në para të gatshme, raportin e ekzekutimit të buxhetit si dhe shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare, përfshirë përmbledhjen e politikave të rëndësishme të kontabilitetit dhe raportet tjera², për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore të Këshillit Prokurorial të Kosovës, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik, sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Konkluzion për pajtueshmërinë

Ne kemi audituar nëse proceset dhe transaksionet përcjellëse janë në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Sipas konkluzionit tonë, transaksionet e kryera në procesin e ekzekutimit të buxhetit të KPK kanë qenë, në të gjitha aspektet materiale, në pajtueshmëri me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislacioni i zbatueshëm për subjektin e audituar në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare.

Baza për konkluzion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa e raportit 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me ONISA-P-10, SNISA 130, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga subjekti i auditimit. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për konkluzion.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe të organeve drejtuese/qeverisëse për pasqyrat financiare vjetore

Drejtori i Sekretariatit është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, Drejtori i Sekretariatit është përgjegjës edhe për vendosjen e kontroleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizata Buxhetore.

Kryesuesi është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Këshillit Prokurorial të Kosovës.

Përgjegjësia e Menaxhmentit për Pajtueshmërinë

Menaxhmenti i Këshillit Prokurorial të Kosovës është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare të Këshillit Prokurorial të Kosovës në përputhje me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësinë dhe të gjitha rregullat dhe rregulloret e tjera të zbatueshme.³

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Objektivat tona janë të ofrojmë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit dhe të hartojmë një raport të auditimit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci se një auditim i kryer në përputhje me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistojë. Keq-deklarimet mund të vijnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose si tërësi, në mënyrë të arsyeshme pritet të ndikojnë në vendimet ekonomike të përdoruesve të marra në bazë të këtyre pasqyrave financiare.

Objektivi ynë është gjithashtu të shprehim një konkluzion të auditimit për pajtueshmërinë e autoriteteve përkatëse të Këshillit Prokurorial të Kosovës me kriteret e përcaktuara të auditimit që burojnë nga legjislati i zbatueshëm në kontekstin e përdorimit të burimeve financiare, lidhur me subjektin e audituar.

Si pjesë e auditimit në përputhje me Ligjin për ZKA dhe SNISA-të, ne ushtrojmë gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e keq-deklarimit material të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që i përgjigjen atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për opinion. Rreziku i mos zbulimit të një keq-deklarimi material që rezulton nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrolleve të brendshme.
- Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e mos-pajtueshmërisë me autoritetet, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit që janë përgjegjëse ndaj atyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazën për konkluzionin tonë për pajtueshmërinë me autoritetet. Rreziku i mos zbulimit të një rasti të mos pajtueshmërisë me autoritetet që vjen nga mashtrimi është më i lartë sesa për atë që rezulton nga gabimi, pasi mashtrimi mund të përfshijë manipulim, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keq përfaqësime ose anashkalim të kontrollit të brendshëm.
- Sigurohemi ta kuptojmë kontrollin e brendshëm relevant për auditimin, për t'i hartuar procedurat e auditimit që janë të përshtatshme, por jo me qëllim të shprehjes së një opinioni mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Këshillit Prokurorial të Kosovës.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve të kontabilitetit dhe shpalosjet e ndërlidhura të bëra nga menaxhmenti.
- Vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë shpalosjet, për t'u siguruar se pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet themelore në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Ndër të tjera, ne komunikojmë me menaxhmentin dhe ata që janë përgjegjës për qeverisjen edhe në lidhje me fushëveprimin dhe kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi domethënëse në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Nga çështjet e komunikuar me menaxhmentin, ne përcaktojmë ato çështje që ishin më të rëndësishme në auditimin e Pasqyrave Financiare të periudhës aktuale dhe që cilësohen si çështje kyçe të auditimit. Raporti i auditimit publikohet në ueb faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si senzitive apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2 Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur një fushë për përmirësim të mundshëm, përfshirë kontrollin e brendshëm, e cila është paraqitur më poshtë për shqyrtimin tuaj në formë të gjetjes dhe rekomandimit. Kjo ka për qëllim të përmirësojë kontrollet e brendshme lidhur me raportimin financiar dhe pajtueshmërinë me autoritetet në lidhje me menaxhimin e fondeve të sektorit publik. Ne do të përcjellim (shqyrtojmë) këtë rekomandim gjatë auditimit të vitit të ardhshëm.

Ky raport ka rezultuar me një rekomandim të ri.

Derisa për statusin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe nivelin e zbatimit të tyre, shih kapitullin 4.

2.1 Çështjet tjera të menaxhimit financiar dhe të pajtueshmërisë

2.1.1 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 615,906€, prej tyre në 2021 ishin shpenzuar 562,864€. Ato kanë të bëjnë me investime në objekte, blerje të veturave zyrtare, pajisje teknologjike informative etj. Kemi testuar gjashtë mostra për teste substanciale dhe të pajtueshmërisë në vlerë 329,163€, si dhe pesë procedura të prokurimit.

Çështja A1 - Keq klasifikim i shpenzimeve

Gjetja	<p>Sipas nenit 18 pika 3 të Rregullës financiare nr. 01/2013 MF Shpenzimi i parasë publike - shpenzimet duhet të jenë në kode adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ (UA) 19/2009 për planin kontabël.</p> <p>Në tri raste pagesat në vlerë prej 127,317€ ishin klasifikuar gabimisht, pasi që ishin paguar nga investimet kapitale, mirëpo sipas natyrës i takonin kategorisë së mallrave dhe shërbimeve. Pagesat kishin të bënin kryesisht me blerjen e pajisjeve të teknologjike informative me vlerë individuale nën 1,000€ (Kompjuter, Monitor, Laptop, etj.) dhe të njëjtat kishin qenë të buxhetuara në programin për investime kapitale.</p> <p>Kjo kishte ndodhur për shkak se planifikimi i këtyre pajisjeve ishte konsideruar si pjesë e projektit.</p>
Ndikimi	<p>Shpenzimi i buxhetit të investime kapitale për mallra dhe shërbime, rezulton me një pasqyrë jo të saktë të shpenzimit në PFV. Kjo mbivlerëson kategorinë e investimeve kapitale dhe e nënvlerëson kategorinë e mallrave dhe shërbimeve.</p>
Rekomandimi A1	<p>Kryesuesi i KPK-së, duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme që të shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit apo të bëhet ridestitim të mjeteve dhe që realizimi i pagesave të bëhet në kategorinë adekuate për të mundësuar raportimin e drejtë të tyre në PFV, në përputhje me planin kontabël.</p>

Përgjigja e menaxhmentit të entitetit (Nuk pajtohen)

Me gjerësisht shih Shtojcën I

3 Informacion i përmbledhur për planifikimin dhe realizimin e buxhetit

Në këtë kapitull kemi prezantuar një informacion të përmbledhur për burimet e fondeve buxhetore, shpenzimin e fondeve dhe të hyrave të mbledhura, sipas kategorive ekonomike. Kjo është ilustruar përmes tabelave dhe grafikëve të mëposhtëm:

Tabela 1. Shpenzimet sipas burimeve të fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final ⁴	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
Burimet e fondeve	14,441,528	13,536,245	13,324,362	13,298,647	13,715,048
Grante Qeveritare - Buxheti	14,441,528	13,536,237	13,324,362	13,298,647	13,396,353
Te hyrat nga AKP-ja	0	0	0	0	318,695
Donacionet e jashtme	0	7	0	0	0

Buxheti përfundimtar është më i ulët se buxheti fillestar për 905,283€. Ky zvogëlim apo ndryshim i buxhetit është rezultat i rishikimit të buxhetit për vlerën 43,725€, vendimeve të Qeverisë për ndarje dhe kursime buxhetore në vlerë prej 949,001€, si dhe rritja për 7€ nga vlera e mbetur e donacionit të jashtëm.

Në vitin 2021 OB ka shpenzuar 98% të buxhetit përfundimtar në 2021 ose 13,324,362€, me një përmirësim prej 1% në krahasim me vitin 2020. Shpjegimet për pozicionin aktual janë detajuar më poshtë.


Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Shpenzimet	2020 Shpenzimet	2019 Shpenzimet
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike	14,441,528	13,536,245	13,324,362	13,298,647	13,715,048
Pagat dhe mëditjet	10,772,146	10,592,055	10,592,055	10,622,010	10,410,291
Mallrat dhe shërbimet	2,235,252	2,204,192	2,054,132	1,887,106	2,243,322
Komunalitë	199,630	124,092	115,310	124,082	131,386
Investimet Kapitale	1,234,500	615,906	562,864	665,450	930,049

Shpjegimet për ndryshimet në kategoritë e buxhetit janë dhënë më poshtë:

- Buxheti final për paga dhe mëditje krahasuar më buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 180,091€. Fillimisht buxheti ishte rritur me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit mbi ndarjet buxhetore për 103,725€, ndërsa me vendim të qeverisë është zvogëluar buxheti për 283,816€. Shpenzimet në këtë kategori ishin 100% e buxhetit final;
- Buxheti final për mallra dhe shërbime krahasuar më buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 31,060€. Ndryshimet kanë ndodhur me vendime të qeverisë për kursime buxhetore. Shpenzimet në këtë kategori ishin 93% e buxhetit final;
- Buxheti final për shërbime komunale krahasuar më buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 75,538€. Ndryshimet kanë ndodhur me vendime të qeverisë për kursime buxhetore. Shpenzimet në këtë kategori ishin 91% e buxhetit final; dhe
- Buxheti final për investime kapitale krahasuar më buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 618,594€. Fillimisht buxheti ishte zvogëluar me ndryshimin dhe plotësimin e ligjit mbi ndarjet buxhetore për 60,000€, ndërsa me vendim të qeverisë është zvogëluar buxheti për 558,594€. Shpenzimet në këtë kategori ishin 93% e buxhetit final.

Grafiku 1. Shpenzimet sipas kategorive ekonomike për vitin 2021



Të hyrat e realizuara nga KPK në vitin 2021 ishin në vlerë 16,245€. Ato mblidhen për fondin për kompensimin e dëmit të viktimave të veprave penale

Tabela 3. Të hyrat (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti final	2021 Pranimet	2020 Pranimet	2019 Pranimet
Totali i të hyrave	19,205	38,666	16,245	18,700	42,013
Të hyrat jo tatimore	19,205	38,666	16,245	18,700	42,013

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e vitit 2020 nuk kishte rezultuar me asnjë rekomandim.

Vlora Spanca, Auditore e Përgjithshme



Naser Arllati, Ndihmës Auditor i Përgjithshëm



Blerina Krasniqi, Drejtore e Auditimit



Astrit Bllaca, Udhëheqës i ekipit



Albana Kadriu, Anëtare e ekipit



Shtojca I: Letër konfirmimi / Tabela për Komentet e OB-së lidhur me raportin e auditimit

Çështja	Komenti i OB-së	Pikëpamja e ZKA-së
<p>Në tri raste pagesat në vlerë prej 127,317€ ishin klasifikuar gabimisht, pasi që ishin paguar nga investimet kapitale, mirëpo sipas natyrës i takonin kategorisë së mallrave dhe shërbimeve. Pagesat kishin të bënin kryesisht me blerjen e pajisjeve të teknologjisë informative me vlerë individuale nën 1,000€ (Kompjuter, Monitor, Laptop, etj.) dhe të njëjtat kishin qenë të buxhetuara në programin për investime kapitale.</p>	<p>Projekti kapital “Pajisjet Harduerike dhe Softuerike të Teknologjisë Informative” është projekt kapital që në tërësinë e këtij projekti përfshihen asete kryesisht mbi 1,000 euro dhe asete me vlerë nën 1,000 euro si pjesë e tërësishme e këtij projekti.</p> <p>Projekti në fjalë është klasifikuar si projekt kapital në bazë të standardeve të kontabilitetit dhe gjithashtu plotëson kriteret e përcaktuara komfor edhe udhëzimit UA MF-nr 04/2019 përkatësisht nenit 5 paragrafi 1 dhe 2 i këtij neni dhe nenit 6 paragrafi 4, udhëzim ky i cili ka filluar të zbatohet për projektet kapitale të planifikuara nga viti 2020. Po ashtu, furnizimet në fjalë nuk kishin ndryshe si të emërtohen, klasifikohen apo edhe të regjistrohen përveç kësaj siç e parasheh UA i cekur më lartë. Pavarësisht, se në furnizimet me pajisje të TI kishte pajisje me vlerë më pak se njëmijë euro, ato pajisje ishin pjesë apo furnizime të ndërlidhura të projektit kapital si tërësi.</p> <p>Regjistrimi i pasurisë, të siguruar përmes këtij projekti, është bërë sipas udhëzimeve aktuale në fuqi, pasuria mbi 1,000 është regjistruar në SIMFK, ndërsa pasuria nën 1,000 euro është regjistruar në E-pasuri, që realisht kjo</p>	<p>UA Nr. 04/2019 në të cilin jeni thirrur ju, neni 4, specifikon kriteret për projektet kapitale. Bazuar në këto kritere, pagesat e identifikuar tek gjetja e auditimit, nuk i plotësojnë kriteret përkatëse, andaj si të tilla janë të keq klasifikuara. E gjetura mbetet e pa ndryshuar.</p>

pasqyron një vlerë të saktë të regjistrit të pasurisë duke përfshi këtu edhe pasuritë mbi dhe nën 1,000 euro.

Ky projekt është projekt t i vazhdueshëm që nga viti 2019. Në tërësi projekti tashmë i vazhduar, duhet te shikohet dhe vlerësohet si një projekt i tërë dhe i pa ndashëm.

I njëjti projekt ka qene mostër e auditimit dhe nuk ka pas vërejtje për te njëjtin, projekt i ngjashëm ka qene edhe në vitin 2018 që gjithashtu ju ka nënshtruar procesit të auditimit.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic Of Kosovo
Këshilli Prokurorial i Kosovës - Tužilački Savet Kosova - Kosovo Prosecutorial Council

LETËR E KONFIRMIMIT

Për mos pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për vitin
 2021

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
DATE: 10.05.2022			
Ajete Org. Org. Jedin. Org. Unit.	Shif. klasif. Klasif. Kod Class. Code	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Nr. i Faqeve Br. Stranica No. Pages
06	47	700	3

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Këshillit Prokurorial të Kosovës, për vitin 2021 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- nuk pajtohem me gjetjen dhe rekomandimin dhe bashkangjitur me këtë letër konfirmim e gjeni edhe komentimin në lidhje me të gjeturën dhe rekomandimin e pasqyruar në raportin e auditimit të vitit 2021.

z. Jetish Maloku

Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës

Data: 10.05.2022, Prishtinë



Shtojca II: Shpjegim lidhur me llojet e të ndryshme të opinionëve të aplikuara nga ZKA dhe pjesëve të tjera të Raportit të Auditimit

Raporti i auditorit për pasqyrat financiare⁵ duhet të përmbajë një opinion për pasqyrat financiare, bazuar në përfundimet e nxjerra nga dëshmitë e marra gjatë auditimit. Kur auditimi kryhet për të vlerësuar gjithashtu përputhjen me legjislacionin dhe rregulloret e tjera, auditorët kanë një përgjegjësi shtesë për të raportuar për pajtueshmërinë me autoritetet⁶, duke rezultuar me konkluzion mbi pajtueshmërinë.

Për të arritur në përfundimin se një opinion mbi pasqyrat financiare është i modifikuar ose i pa modifikuar, një auditor duhet të sigurohet që rezultatet e auditimit përfshijnë, apo jo, keq-deklarim (e) material(e) ose të përhapur(a), apo të tillë(a) të mundshëm(me), të supozuar në rast kufizimi të fushëveprimit.

Keq-deklarimi është një ndryshim mes shumës së raportuar, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit të një zëri të pasqyrës financiare dhe sasisë, klasifikimit, prezantimit ose zbulimit që kërkohet që zëri të jetë në përputhje me kornizën e raportimit financiar në fuqi. Keq-deklarimet mund të vijnë nga gabimi ose mashtrimi.

(shkëputur nga SNISA 200)

Forma e opinionit

Opinion i pa-modifikuar

Formulohet kur nuk janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri; kur janë zbuluar keq-deklarime ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, por që nuk është i barabartë me ose nuk e tejkalon nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi(et) dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh nuk është e barabartë me ose e tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse nuk ka kufizim të fushëveprimit ose kur kufizimi i fushëveprimit nuk mund të shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e) dhe/ose mos-pajtueshmërisë(ve).

Kufizimi i fushëveprimit ndodh kur një auditor nuk është në gjendje të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Auditori duhet të japë **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Modifikimi i opinionit në raportin e auditorit

Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit nëse konstatohet se, bazuar në dëshmitë e marra nga auditimi, pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri, ose nuk është në gjendje të sigurojë prova të mjaftueshme të auditimit për të arritur në përfundimin se pasqyrat financiare në tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale dhe/ose mos-pajtueshmëri..

Opinionin i modifikuar mund të jetë:

- I kualifikuar,
- I kundërt, ose
- Mohim opinionin

Opinionin i kualifikuar

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që janë të barabartë me ose e tejkalojnë nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimi dhe/ose mos-pajtueshmëria e zbuluar brenda një klase të caktuar transaksionesh është i barabartë me ose tejkalon nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve. Formulohet gjithashtu nëse ka kufizim të fushëveprimit, i cili mund të mos shpie në shmangie të keq-deklarimit(eve) material(e).

Opinionin i kundërt

Formulohet kur janë zbuluar keq-deklarime dhe/ose mos-pajtueshmëri, qoftë një i vetëm apo një grumbull, që tejkalon në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit për pasqyrat financiare si tërësi; ose kur keq-deklarimet dhe/ose mos-pajtueshmëritë e zbuluara brenda një klase të caktuar transaksionesh e tejkalojnë në mënyrë të përhapur nivelin e materialitetit më të ulët të vendosur për këtë klasë të transaksioneve.

“E përhapur” është term që përdoret, në kontekstin e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërive, për të përshkruar efektet e keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë në pasqyrat financiare; ose efektet e mundshme në pasqyrat financiare të keq-deklarimeve dhe/ose mos-pajtueshmërisë, nëse ka të tilla, që nuk zbulohen për shkak të pamundësisë për të marrë dëshmi të mjaftueshme e të duhura të auditimit. Efektet e përhapura në pasqyrat financiare janë ato që, sipas gjykimit të auditorit::

- a) Nuk kufizohen vetëm në elemente, llogari ose zëra të veçantë të pasqyrave financiare;
- b) Por nëse kufizohen si të tilla, përfaqësojnë ose mund të përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të pasqyrave financiare; ose
- c) Për sa i përket shpalosjeve, janë thelbësore që përdoruesit të kuptojnë pasqyrat financiare.

Mohim i opinionit

Formulohet kur kufizimi i fushëveprimit, d.m.th. kur pamundësia për të siguruar prova të mjaftueshme të përshtatshme të auditimit, është i natyrës materiale dhe pervazive.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të tërheqë vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka dëshmi të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq-deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë paragrafin e Theksimit të çështjes në raportin e tij. Paragrafi për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohet vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

Paragrafi i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionin e auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

Nëse auditori e konsideron të nevojshme të komunikojë një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që të kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje të tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të çështjes.

Shënimet fundore

- ¹ Pajtueshmëria me autoritetet - pajtueshmëria me të gjitha ligjet, rregullat, rregulloret, standardet dhe praktikatat e mira relevante në sektorin publik
- ² Raportet tjera janë kërkesë e nenit 8 të së Rregullores 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar
- ³ Kolektivisht të referuara si pajtueshmëri me autoritetet
- ⁵ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave
- ⁶ Pasqyrat financiare në sektorin publik përfshijnë po ashtu edhe pasqyrën(at) e ekzekutimit të buxhetit
- ⁷ Pajtueshmëria me autoritetet: pajtueshmëria me ligjet, rregulloret, standardet, apo praktikatat e mira.